

VENDIM
Nr. 110, datë 4.2.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT SHETETËROR
PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR (ASIG), AGJENCISË KOMBËTARE PËR
SIGURINË KOMPJUTERIKE (ALCIRT), AGJENCISË SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË
DHE INOVACIONIT (AKTI), AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK (AKCE), AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT (AKSHI) DHE AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK (APP) TË
MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) “ISH-INIMA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) dhe Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, për mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve, si më poshtë vijon:

a) Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) dhe Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) u kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 683 m², të zyrave të katit të parë të godinës, sipas planimetrisë aneksi 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) u kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 700 m², të zyrave të katit të dytë të godinës, sipas planimetrisë aneksi 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, për mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) i kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 900 m², të zyrave të katit të dytë, sipas planimetrisë Aneksi 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) i kalojnë në përgjegjësi administrimi mjediset me sipërfaqe prej 454.2 m², të zyrave të katit të parë të godinës, sipas planimetrisë Aneksi 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Këtyre institucioneve u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Vendimi nr. 560, datë 16.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Integritetit për ushtrimin e veprimtarisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 324, datë 30.5.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA””, vendimi nr. 153, datë 11.2.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Qendrës Kombëtare të Licencimit të disa mjediseve në ndërtesën (godinën) e INIMA””, shfuqizohen.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave të marrin masat përkatëse për ndarjen dhe organizimin e agjencive të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, në mjediset e godinës.

6. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe kryerregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1



Sipërfaqja e Qendres Kombetare te Lincesimit
eshte 900 m2



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	65.920 m ²
2	20.329 m ²
3	17.462 m ²
4	58.238 m ²
5	10.398 m ²
6	20.817 m ²
7	21.140 m ²
8	21.529 m ²
9	21.515 m ²
10	20.968 m ²
11	20.926 m ²
12	15.203 m ²
13	25.723 m ²
14	13.142 m ²
15	26.318 m ²
16	9.357 m ²
17	10.832 m ²
18	3.428 m ²
19	3 m ²
20	46.069 m ²

ANEKSI 2

Sipërfaqja në përdorim QKR është 454.2 m².



Zyra	Punonjës
1	1
2	1
3	1
4	4
5	9
6	9
7	1
8	4
9	2
10	2
11	5
Sportelet	11

ANEKSI 3


Pjesa veri lindore e godinës. Kati i parë i ambienteve ka një sipërfaqe totale prej: $S = 683.555 \text{ m}^2$



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	14.445 m ²
2	23.101 m ²
3	6.312 m ²
4	77.793 m ²
5	23.169 m ²
6	22.816 m ²
7	22.554 m ²
8	22.601 m ²
9	22.776 m ²
10	22.885 m ²
11	31.955 m ²
12	14.862 m ²
13	10.484 m ²
14	10.395 m ²
15	13.524 m ²
16	13.413 m ²
17	68.765 m ²
18	17.680 m ²

ANEKSI 4

Kati i dytë i ambienteve ka sipërfaqe të
përgjithshme $S = 700.921 \text{ m}^2$



Nr. i Zyres	Sipërfaqja në m ²
1	14.445 m ²
2	23.101 m ²
3	32.179 m ²
4	10.712 m ²
5	23.169 m ²
6	22.816 m ²
7	22.554 m ²
8	22.601 m ²
9	22.776 m ²
10	22.885 m ²
11	31.955 m ²
12	14.862 m ²
13	12.015 m ²
14	12.015 m ²
15	11.559 m ²
16	11.559 m ²
17	23.392 m ²
18	22.676 m ²
19	22.793 m ²
20	14.383 m ²
21	4.780 m ²

